

VENDIM
Nr. 31, datë 28.2.2022

MBI NDËRTIMIN E MJETEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, ME QËLLIM REGJISTRIMIN E AKSESIT NË TË DHËNAT E MATJES SË STANDARDEVE TË PERFORMANCËS SË CILËSISË “SPC” NGA OPERATORËT E RRJETIT TË GAZIT NATYROR DHE ÇDO I LICENCUAR NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT ME GAZ NATYROR

Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 16, pika 18, nenit 48, pika 5 dhe nenit 53, pika 5, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 113, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 28.2.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike me nr. 263/1 prot., datë 21.2.2022, “Mbi ndërtimin e mjeteve të teknologjisë së informacionit me qëllim regjistrimin e aksesit në të dhënat e matjes së ‘QPI’ nga operatorët e rrjetit të gazit natyror”,

konstatoi se:

Në nenin 5.2, të “Rregullores për përcaktimin e standardeve dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit në sektorin e gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 100, datë 21.6.2019 dhe ndryshimeve të miratuara me vendimin e Bordit nr. 6, datë 15.1.2021, është parashikuar që:

“Jo më vonë se 21.6.2021, OSSH-G, OST-G dhe çdo i licencuar tjetër përkatës do të ndërtojnë mjetet e përshtatshme, duke përfshirë edhe mbi bazë IT (teknologji informacioni), të aftë për të regjistruar dhe për të mundësuar aksesin në të dhënat aktuale dhe ato historike të QPI-së”.

- Me përfundimin e afatit të parashikuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 6, datë 15.1.2021, ERE, me anë të shkresës nr. 784 prot., datë 29.6.2021, i është drejtuar shoqërisë “Albgaz” sh.a., me kërkesë për informacion, në lidhje me masat e marra nga ana e kësaj shoqërie, për plotësimin e kushteve të parashikuara në nenin 5.2, të “Rregullores për përcaktimin e standardeve dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit në sektorin e gazit natyror”.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 102/1 prot., datë 7.9.2021, kërkon që afati i paracaktuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 6, datë 15.1.2021, të shtyhet deri në datën 21.12.2022.

- Në vijim, është zhvilluar seancë dëgjimore me përfaqësues të shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe përfaqësues nga ERE, me objekt diskutimin në lidhje me propozimin e kësaj shoqërie, për shtyrjen e afatit të përmbushjes së detyrimit që rrjedh nga zbatimi i pikës 5.2, të “Rregullores për përcaktimin e standardeve dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit në sektorin e gazit natyror”, si dhe nga ana e përfaqësuesve të kësaj shoqërie u bë me dije se megjithëse nuk kanë pasur asnjë aktivitet në fushën e furnizimit me gaz natyror të klientëve fundor, ata kanë kontaktuar dy shoqëri për implementimin e platformës IT.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 3 prot., datë 7.1.2022, argumentoi dhe paraqiti prova shkresore të korrespondencës midis shoqërisë dhe ekspertëve të kontaktuar me qëllim ndërtimin e teknologjisë së informacionit, ku mbështeste kërkesën e saj për shtyrjen e afatit të përmbushjes së detyrimit që rrjedh nga zbatimi i pikës 5.2, të “Rregullores për përcaktimin e standardeve dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit në sektorin e gazit natyror”, deri më datë 22.12.2022.

- Në raportimet e shoqërisë “Albgaz” sh.a., vërehet se nuk ka asnjë aktivitet të furnizimit me gaz natyror të klientët fundor. Nisur nga kjo situatë, gjykohet se zbatimi ose moszbatimi i detyrimit që rrjedh nga pika 5.2, e “Rregullores për përcaktimin e standardeve dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit në sektorin e gazit natyror”, nuk sjell asnjë pasojë juridike për palët.

- Në kushtet kur kjo shoqëri nuk ka aktivitet furnizimi me palë të treta dhe nuk siguron të ardhura financiare nga ky aktivitet, shpjegimet e dhëna nga shoqëria “Albgaz” sh.a., në lidhje me pamundësinë objektive për të përmbushur kushtet e vendosura në nenin 5.2, të “Rregullores për përcaktimin e standardeve dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit në sektorin e gazit natyror”, konsiderohen të arsyeshme.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. OSSH-G dhe OST-G, dhe çdo i licencuar në aktivitetin e furnizimit me gaz natyror të ndërtojnë mjetet e përshtatshme, duke përfshirë edhe mbi bazë IT (teknologji informacioni) të parashikuara në nenin 5. 2, të “Rregullores për përcaktimin e standardeve dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit në sektorin e gazit natyror”, pasi të ketë filluar ushtrimin e aktivitetit të furnizimit për klientë fundorë 1 nga furnizuesit e licencuar në këtë aktivitet nga ERE.

2. Afati i përcaktuar në nenin 5.2, të “Rregullores për përcaktimin e standardeve dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit në sektorin e gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 100, datë 21.6.2019, të ndryshuar, shfuqizohet.

3. Kudo në “Rregulloren për përcaktimin e standardeve dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit në sektorin e gazit natyror”, shkurtimi QPI korrigjohet me shkurtimin SPC.

4. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a., çdo të licencuar në aktivitetin e furnizimit me gaz natyror, si dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti